



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. _____prot.

Vlorë, më _____._____2025

Procesverbal Nr 1, i mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, mbledhje jashtë radhe, datë 10 Janar 2025.

Mbledhjen e hapi Kryetarja e Këshillit Bashkiak znj. Elpiniqi Mërkuri Mirëmëngjes të gjithëve. Faleminderit për prezencën në mbledhjen e thirrur nga Bashkia Vlorë jashtë radhe me rend dite:

1. PV “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmytja e datës 04.10.2024 në banesat e qytetarëve dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”
2. PV “Për dhënien e grantit të menjëhershëm nga Buxheti i Shtetit, familjes së z. Agim Selfo Mecnaj, trajtuar me banesë sociale me kosto të ulët me V.K.B nr.6 dt.29.01.2024
3. PV “Për miratimin e zbatimit të banesave me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga Buxheti i Shtetit, miratimi i sistemit të pikëzimit, niveli minimal dhe maksimal të të ardhurave dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë familjet/individët që përfitojnë nga ky program”

Për rendin e ditës ka dikush dicka?

E kalojmë në votim.

40 vota PRO

0 vota KUNDËR

0 vota ABSTENIM

Znj.Elpiniqi Mërkuri: Pika e parë e rendit të ditës.

PV “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmytja e datës 04.10.2024 në banesat e qytetarëve dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë” Kemi koment nga anëtarët e komisionit apo drejtoritë përkatëse?

z. Artid Hoxha. Faleminderit dhe i uroj vit të mbarë KB dhe qytetarëve të Vlorës. Dua një përgjigje nga administrata. Evidentimi i dëmeve për subjektet familjare, konstatimet nga ekspertët për llogaritë financiare, vlerat shumë të ulta. Qytetarët kanë dakortësuar apo jo me ekspertët e qarkut? Në PV s’ka asgjë për bizneset, për shkak të përmytjeve kanë dëme financiare, jo vetëm familjet, janë edhe bizneset, që në PV s’ka zgjidhje as fjalë. Subjektet ushqejnë familjet. Nga Bashkia dhe Qarku, minimalisht të kishte konstatime, pastaj ka fond të pakushtëzuar apo jo është tjetër gjë. Dëmet janë shumë

herë më shumë se 56 milion...cështja u takon edhe qytetarëve, vlerës së përvaktuar, dakortësia ose jo nga qytetarët. Dëme kanë edhe bizneset, që s'ka zgjidhje. Nuk janë 56 milion lek dëmet e shkaktuara. I kemi parë edhe në media. Kërkoj KB, anëtarëve për këtë problem, të konstatohen minimalisht dëmet, pastaj raporti financiar është cështje administartive. Të informohet këshilli në këtë mbledhje jashtë radhe, s'ka raportime për dëmet e biznesit. Jam pro që famlijarët të marrin dëmshpërblime. Pastaj nëse qytetarët s'janë dakort me vlerën të bëj ankimim administrativ.

Znj.Elpinqi Mërkuri. Faleminderit.

Elca Bezhani: Përshëndetje. PV për dëmshpërblimin e kanë ndjekur si procedure nga Drejtoria e Emergjencave Civile. Vlerësimet nga ekspertët, punonjësit e rajoneve për evidentimin e dëmeve që u thanë, Bashkia Vlorë ka dhënë ndihma të ndryshme, kësaj vlere i janë zbritur donacionet. Sot, në këtë mbledhje jashtë radhe, ka dhe si qëllim të shfrytëzohet fondi i emergjencës civile deri në fund të janarit. Për bizneset është e drejte të kemi info, të kërkohet nga emergjencat civile për dëmet. Të bëhet vlerësimi dhe të marrin ato që ju takojnë. Të bëhet vlerësimi administrativ.

Znj.Alda Haluci. Jemi dakort për familjet e përmbytura edhe për bizneset, çiftet e reja, familjet e reja. Është aplikuar dhe s'kanë marrë përgjigje. Familjet që do kompensohen. Jo të gjithë e kanë patur informacionin. E kanë marrë të gjitha familjet? Ka familje nga Rajoni 1, a kanë patur mundësi të plotësojnë formularin. Për koston është tjetër gjë. Për bizneset e reja të shikohen me përkrahje. Cifti Mezini ka farmaci dhe ju është shkaktuar dëm financiar.

Znj. Elca Bezhani: Në banesat e familjeve, specialistet e drejtorisë së emergjencave civile, kanë evidentuar dëmet, s'ka pas nevojë të vinë. Janë mbajtur shënime për cdo familje.

Znj.Alda Haluci: Disa emra që i njoh janë përmbytur dhe prandaj përmenda aplikimin.

Z. Ardian Vreshtazi - Drejtor Emergjencave Civile: U evidentuan në terren cdo familje. Janë njoftuar banorët. U veprua sa më shpejt në gjendje emergjence së bashku edhe me ekspertët e qarkut. Grupi i punës u gjend sa më shpejt, ata që s'kanë qënë prezent. Nëse ka ndonjë të pa evidentuar jemi të gatshëm të shkojmë.

Znj.Elpinqi Mërkuri: Faleminderit drejtor.

Znj.Alda Haluci. Jam dakort. Z.Besnik Xhelo, ka pësuar dëm të madh, banon afër në një shkollë private, në Rajonin 1, ka patur shumë dëme dhe djegie të pajisjeve elektroshtëpiake. Cfarë ka parë grupi? S'ka lidhje me aplikimin. Nuk e di si nuk është vënë re.

Z. Ardian Vreshtazi - Drejtor Emergjencave Civile: Kur u bë evidentimin në terren, muret rrethues nuk përfshihen në VKM janë të saktësuara mënyrat e llogaritjes. Janë 2 probleme që duhet të kihet parasysh. Rasti i parë është kur shpallet gjendja e emergjencës civile dhe rasti i 2 kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile. Konkretisht jemi në rastin kur nuk u shpall gjendja e jashtëzakonshme dhe llogaritjet u bënë vetë me banoët në banesat ku shkuam. Dëshira ime mund të ishte për ti ndihmuar por VKM saktëson mënyrën e llogaritjes. U mbajtën procesverbalet e konstatimit dhe në bashkpunim dhe me ekspertët e qarkut. Cmimet janë llogaritur në bashkëpunim me institucionet, nga drejtoria e tatimeve për elektroniket dhe nga Enti i Banesave për banesat.

Znj. Elca Bezhani: Keni dijeni për familjen në Rajonin 1?

Z. Ardian Vreshtazi- Nuk kam dijeni.

Z. Skerdilajd Hunda - Administrator Rajoni 1: Familja Xhelo ka patur problemin me murin rrethues. S'ka patur dëme në pajisje.

Znj. Elpiniqi Mërkuri: dëmshpërblimi është për pajisjet.

Znj. Ervis Mocka: Faleminderit për gatishmërinë për mbledhjen. Ka qëllim të mirë. Ti vimë në ndihmë familjeve të prekura. Është punë voluminoze. Emergjinca Civile dhe administrata kane qene në terren gjatë procesit mund të ketë që s'janë bërë evidentimet. Por nuk është i përjashtuar. Do vazhdoj, nuk do përjashtohet asnjë. Kemi një fond prej 56 milion ..vjen në ndihmë të familjeve. Është bërë punë voluminoze e E.C. shtëpi më shtëpi. Janë procesuar 373 dosje për një muaj me qëllim mos të digjet fondi brenda janarit. VKM 329, procesi është ndjekur sipas manualit përkatës, spacialistët marrin cmimet nga dogana, tatimet, për orenditë. Sot KB për tu mbledhur në mënyrë të jashtëzakonshme. Znj. Bezhani dhe z. Hoxha e ngritën me të drejtë edhe për bizneset. Nuk i kemi kompetencat për bizneset por jemi përfaqësues dhe do e ndjekim që të marrin shpërblim të gjithë. Ky PV do marri votat që të marrin fondin e dëmshpërblimit dhe të ndjekim cdo shqetësim të banorëve.

Znj.Elpiniqi Mërkuri: E kalojmë në votim.

40 vota PRO

0 vota KUNDËR

0 vota ABSTENIM

Znj. Elpiniqi Mërkuri. Pika 2 e rendit të ditës. PV “ Për dhënien e grantit të menjëhershëm nga Buxheti i Shtetit, familjes së z. Agim Selfo Mecnaj, trajtuar me banesë sociale me kosto të ulët me V.K.B nr.6 dt.29.01.2024”. Kush e do fjalën?

Z.Illir Aliaj: Përshëndetje. Ky PV kaloi në komision me 4 vota PRO. Bëhet fjalë për familjen e z. Agim Mecnaj, i cili është përfitues i banesës më kosto të ulët. U pyet drejtorja përkatëse. Mund të ketë edhe familje të tjera që mund të përfitonin. Drejtorja i ka njoftuar familjet për të përfituar grantin 10%. U propozua nga anëtarët e komisionit, duke qënë se një pjesë e familjeve nuk janë në gjendje të përgatisin dokumentacionin, nga Bashkia të jetë një përfaqësues që të bëjë jo vetëm njoftimin por edhe ti asistoj. Në vazhdim të kenë mundësi të përfitohet granti edhe nga familje të tjera.

Znj. Edlira Kapllani: Faleminderit edhe punë të mbarë. Z. Agim Mecnaj përfaqëson komunitetin egjiptian. Faleminderit institucionit që hapën programin e grantit në mënyrë që banorët të kenë mundësi të rregullojnë banesat e tyre. Faleminderit për vlerën financiare. Faleminderit Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Faleminderit Skerdit, Bledit, Emanuelës për përkushtimin.

Znj.Elpiniqi Mërkuri: Falenderoj të 5 rajonet.

Z. Artid Hoxha. Bëjnë punën dhe paguhen, nuk kam pse i falenderoj. S'dua ti falenderoj, të bëjnë më shumë, të bëjnë shumë më shumë sepse ka probleme të shumta. S'bëj qoka. Kanë bërë punën e tyre. Për PV, kërkoj që administrata znj.Drita, të njoftoj qytetarët si të përfitojnë grantin 10% te banesat me kosto të ulët. Nëse e përfiton vetëm 1 person është proces selektiv, ka familje të tjera me kushte më të këqija. Kërkoj nga administrata të mirëinformoj qytetarët që mund të përfitojnë grantin e VKM. Për kryetarët e rajoneve, të falenderojmë kryetarin e rajonit 5 që përfitoi grantin familja në fjalë.

Znj.Elpiniqi Mërkuri: Ta kalojmë në votim!

40 vota PRO

0 vota KUNDËR

0 vota ABSTENIM

Znj. Elpiniqi Mërkuri: Pika 3 e rendit të ditës. PV “Për miratimin e zbatimit të banesave me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga Buxheti i Shtetit, miratimi i sistemit të pikëzimit, niveli minimal dhe maksimal të të ardhurave dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë familjet/individët që përfitojnë nga ky program”

Referim nga kryetari i komisionit **z. Aliaj**.

U paraqit në komision dhe ky PV. Janë pasqyruar tabelat e pikëzimit për familjet që përfitojnë kredi të buta dhe dokumentat që duhet të plotësohen. Pasi dëgjuam relacionin nga drejtoria përkatëse dhe për tabelat e pikëzimit u vendos. Te pika 2 te kushtet familjare pika 4 (familjet e reja...40 vjec) ishte 6 pikë të hiqet 1 pikë dhe ti kaloj pikës 3. Pika 3 të bëhet me 6 pikë.

Te kushtet sociale. Pika 5 të shtohen 2 pikë që të hiqen 1 pikë nga komuniteti rom dhe egjiptian dhe 1 pikë nga komuniteti LGBT. Ra pika 5 me 4 pikë. Dhe u votua me 4 vota pro. Familjet që kanë nevojë për kredi të aplikojnë pranë Bashkisë Vlorë.

Znj. Elpiniqi Mërkuri: Faleminderit.

Z. Grigor Dede: Faleminderit. Në lidhje me PV, Ligji 22/2018 Për strehimin Social. Kriteri i të ardhurave. Problemi qëndron kur ligji ka ndryshuar, banesat që duhet të përfitohen nga familjet me të ardhura maksimale sa 1/6 e cmimit të referencës së banesës. Ky është problem. Si për familjet me banesë 2+1, 3+1 edhe nëse janë me pagë minimale e tejkalojnë këtë vlerë. Administrata të flasë me ministrinë, Entin ose të ndryshoj cmimin e referencës ose të ndryshoj tavanin e të ardhurave sepse Ligji ka ndryshuar. Familjet me të ardhura minimale nuk marrin dot kredi në bankë. S’ka garanci banka dhe nuk i kualifikon. Jua lë detyrë administratës. Po përgatis shkresën. Në këtë mënyrë nuk ndihmojmë asnjë. Vetëm ata me ndihmë ekonomike e marrin.

Z.Geron Gunbardhi: Faleminderit dhe vit të mbarë! I përgatita unë i tha ai. Faleminderit Grigor. Kjo është gënjeshtër para fushatë. Me këto cmime se marrin kredinë. Administrata të përgatis shkresë, të rishikohet, që të përfitojnë realisht. Për bizneset të dalim në propozim konkret për entet përkatëse, ajo që u propozua, ulje taksash, dëmshpërblim.

Znj.Edlira Kapllani. Faleminderi kryetare. Dua të them për çështjet sociale, planin social. Sepse shumë familje u përjashtuan nga vlera. 2 pika në diskutim. Të gjithë të angazhohen të monitorojnë gjithë procesin e pikëzimit. Nuk lejoj që të hiqet 1 pikë nga komuniteti rom dhe egjiptian. Është e rëndësishme që programi të shoqërohet me mbështetje afatgjatë të rritet nr.banesave dhe shpërndarja e balancuar e të mirave.

Znj.Elpiniqi Mërkuri: Faleminderit

Z.Artid Hoxha: S’kam diskutim, zonja përfaqëson komunitetin. Bie dakort me z. Dede edhe z. Gunbardhin. Kjo ndihmë financiare nuk mund të përfitohet sepse ata që kanë mundësi ta paguajnë. Do ta miratojmë PV se është në ndihmë të komunitetit. Kriteret të bëjmë presion Ministrisë që të ndryshojnë. Edhe në bashkëpunim me kryetarin e shoqatës së bashkive sepse kjo pikë pengon përfitimin. Dhe nuk ju vin në ndihmë. Do e votoj PV!

Kam një kërkesë. Më vjen keq që varen në shtylla nekrologjitë, duhet të ketë stenda dinjitoze. 5 stenda duhen. Nga Bashkia kush e mbulon këtë sektor.

Z. Ervis Mocka: E vërtetë shqetësimi i konstatuar nga z. Dede. Do e miratojmë. Por është shumë e vështirë për tu realizuar. Edhe të dy të punësuar me paga minimale e tejkalojnë kufirin. Është e pamundur. Ka bashki të tjera që i kanë dhënë zgjidhje ndryshe? Do publikojmë vendimin dhe do presim të s’kualifikohen. Cfarë do bëhet? Nëse duhet ndihmë të bëhemi bashkë.

Znj. Jemi në të njëjtat kushte. Kemi rritje të cmimit të referencës. Mos të paragjykojmë programin. Edhe herën e parë ishim në të njëjtat kushte, me Entin, kalon kësti që merrnin fondin pastaj negocimi, mos të shpallim programin me paragjykim. Jemi në komunikim me ministrinë, bashkitë e tjera kanë vendosur cmimin e referencës. Kush janë mundësitë. Do vazhdojmë hap pas hapi.

Znj.Elca Bezhani: Administrata bëri detyrën bazuar në ligj. Ministria e linjës e merr informacionin nga ASHK vlorë. Pra ASHK ti shikoj cmimet reale dhe tja japi tamam ministrisë. Pra nuk është faj.

Z.Ervis Mocka: Kjo është kredi. Sa më shumë e hapim aq më shumë përfitojnë. Banesa 1+1 për një çift 52 mijë. Sa e vogël është hapsira që të përfitojnë. Cfarë të bëjmë që të zgjerohet, që të përfitojnë.

Z.Artid Hoxha: Kontratat me ASHK

Z.Ervis Mocka: Kemi propozim edhe për ASHK që të përfitojnë sa më shumë. Aplikojnë 300 familje në program dhe në bankë fitojnë 2-3 familje. I s'kualifikon banka.

Znj.Elpiniqi Mërkuri. Ta kalojmë në votim.

41 vota PRO

0 vota KUNDËR

0 vota ABSTENIM